



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.53

16 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.356, datë 27.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Postribë të qarkut të Shkodrës.....	2367
Vendim i KM nr.365, datë 27.3.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër të qarkut të Beratit.....	2374
Vendim i KM nr.366, datë 27.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës	2375
Vendim i KM nr.367, datë 27.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit.....	2376
Vendim i KM nr.368, datë 27.3.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT”, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Korsel” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Çarshovë”.....	2377
Vendim i KM nr.369, datë 27.3.2008	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”.....	2384
Vendim i KM nr.370, datë 27.3.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e katërt).....	2387

Vendim i KM nr.371, datë 27.3.2008	Për kriteret e vlerësimit dhe të shitjes së traktorëve, makinerive e pajisjeve, të marra nga përdoruesit, si dhe të makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit, gjendje në magazinën e projektit “Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR”, të ardhura grant nga Japonia.....	2395
Vendim i KM nr.372, datë 27.3.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.49, datë 27.11.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, organizimin, varësinë strukturore dhe limitin organik të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	2396
Vendim i KM nr.373, datë 27.3.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës.....	2396
Vendim i KM nr.374, datë 27.3.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura lidhëse, Lezhë”.....	2398

VENDIM
Nr.356, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO
TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA
POSTRIBË TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Postribë të qarkut të Shkodrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 5 (pesë) fletë, që përfundon me numrin rendor 169 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Postribë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARI PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU										
Komuna: Postrribë										
Nr.	Numri i pronës sipas VKM	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullosore (EPK) shtrirja gjeografike e EPK-së	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërtesës popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sip. në ha	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues, statusi juridik i përdoruesit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	119	"Rosek-Drisht"	Lugu i shkalles	18a	P.Prodhues	27.5	Per pr.l.drusore	MMPAU	Komuna	
2	120	"	Lugu i shkalles	18b	Inproduktive	8.3	-	"	"	
3	121	"	Faqja e Rucit	19	Inproduktive	22.5	-	"	"	
4	122	"	Faqja e shqopes	20a	P.Prodhues	29.5	Per pr.l.drusore	"	"	
5	123	"	Faqja e ibajve	21a	P.Prodhues	27.5	Per pr.l.drusore	"	"	
6	124	"	Sogje	22a	P.Prodhues	41.5	Per pr.l.drusore	"	"	
7	125	"	Sogje	22b	Inproduktive	5.3	-	"	"	
8	126	"	Faqet e zbardhes	23a	P.Prodhues	8.0	Per pr.l.drusore	"	"	
9	127	"	Faqet e zbardhes	23c	Inproduktive	6.0	-	"	"	
10	128	"	Prozhmi i Imerajve	23d	P.Prodhues	9.8	Per pr.l.drusore	"	"	
11	129	"	Megja e shokeve	24a	P.Prodhues	10.5	Per pr.l.drusore	"	"	
12	130	"	Nen shpellen e kull.	24b	P.Prodhues	8.5	Per pr.l.drusore	"	"	
13	131	"	Shpella e kullotes	24c	Inproduktive	2.0	-	"	"	
14	132	"	Kodra e Dardhave	24d	P.Prodhues	23.5	Per pr.l.drusore	"	"	
15	133	"	Rrahi i Furrave	25a	P.Prodhues	24.8	Per pr.l.drusore	"	"	
16	134	"	Shkambi pllumbave	25b	Inproduktive	7.0	-	"	"	
17	140	"	Kodra e ibres	28a	P.Prodhues	19.6	Per pr.l.drusore	"	"	
18	141	"	Suka e gurres	28b	P.Prodhues	10.3	Per pr.l.drusore	"	"	
19	142	"	Faqet e kulumbrise	29a	P.Prodhues	15.1	Per pr.l.drusore	"	"	

20	143	"	Faqet e kulumbrise	29b	P.Prodhues	12.0	Per pr.l.drusore	"	"	
21	144	"	Faqet e gurit ngulun	30a	P.Prodhues	11.3	Per pr.l.drusore	"	"	
22	145	"	Brinja madhe	30b	P.Prodhues	20.5	Per pr.l.drusore	"	"	
23	146	"	Faqeyt e kulumbrise	31a	P.Prodhues	10.0	Per pr.l.drusore	"	"	
24	147	"	Shpatet e kulumbrise	31b	P.Prodhues	23.2	Per pr.l.drusore	"	"	
25	148	"	Ograja e Metajve	32b	P.Prodhues	33.9	Per pr.l.drusore	"	"	
26	149	"	Faqja e Metajve	33a	P.Prodhues	46.0	Per pr.l.drusore	"	"	
27	150	"	Shpatet e kulumbrise	34a	P.Prodhues	17.6	Per pr.l.drusore	"	"	
28	151	"	Qetat e zeza	34b	P.Prodhues	16.6	Per pr.l.drusore	"	"	
29	152	"	Brinjat e shehut	35a	P.Prodhues	36.2	Per pr.l.drusore	"	"	
30	153	"	Brinja e madhe	35b	P.Prodhues	15.3	Per pr.l.drusore	"	"	
31	164	"	Kujmjeti	43a	Inproduktive	2.3	-	"	"	
32	165	"	Kujmjeti	43b	P.Prodhues	25.1	Per pr.l.drusore	"	"	
33	166	"	Kujmjeti	43c	Boshe	1.0	-	"	"	
34	167	"	Kujmjeti	44	P.Prodhues	29.1	Per pr.l.drusore	"	"	
35	187	"	Faqja e shalajve	53a	P.Prodhues	33.4	Per pr.l.drusore	"	"	
36	188	"	Faqja e brushtes	54a	P.Prodhues	41.6	Per pr.l.drusore	"	"	
37	189	"	Faqja e cilikokut	55a	P.Prodhues	35.4	Per pr.l.drusore	"	"	
45	197	"	Nenderraj	58c	P.Mbrojtes	5.3	Per mb.tokave	"	"	
39	191	"	Faqja e cilikokut	56b	Inproduktive	1.3	-	"	"	
40	192	"	Faqja e cilikokut	56c	P.Prodhues	24.9	Per pr.l.drusore	"	"	
41	193	"	Faqja e cilikokut	56d	P.Prodhues	5.0	Per pr.l.drusore	"	"	
42	194	"	Nenderraj	57a	P.Prodhues	4.3	Per pr.l.drusore	"	"	
43	195	"	Bjeshka e Domnit	57c	P.Prodhues	12.1	Per pr.l.drusore	"	"	
44	196	"	Bjeshka e Domnit	58a	P.Prodhues	23.9	Per pr.l.drusore	"	"	
38	190	"	Faqja e cilikokut	55c	P.Mbrojtes	4.3	Per mb.tokave	"	"	
46	198	"	Nenderraj	58d	P.Mbrojtes	1.0	Per mb.tokave	"	"	
47	199	"	Faqja e kr.Eger	59	P.Prodhues	37.9	Per pr.l.drusore	"	"	
48	200	"	Griha e derrajve	60	P.Prodhues	24.1	Per pr.l.drusore	"	"	
49	201	"	Rrahi Geshtenjes	61a	P.Prodhues	33.9	Per pr.l.drusore	"	"	

50	202	"	Faqja e Cilikokut	61b	P.Prodhues	11.6	Per pr.l.drusore	"	"	
51	203	"	Kodra e Pishes	62a	P.Prodhues	12.6	Per pr.l.drusore	"	"	
52	204	"	Kodra e Pishes	62b	P.Prodhues	51.7	Per pr.l.drusore	"	"	
53	205	"	Kodra e Pishes	63a	P.Prodhues	35.7	Per pr.l.drusore	"	"	
54	206	"	Kodra e Pishes	63c	Inproduktive	8.1	-	"	"	
55	207	"	Kodra e Pishes	64b	P.Prodhues	60.1	Per pr.l.drusore	"	"	
56	208	"	Kodra e Pishes	64c	Inproduktive	5.8	-	"	"	
57	209	"	Faqja e shemzave	65b	P.Prodhues	33.4	Per pr.l.drusore	"	"	
58	210	"	Faqja e gjurajve	66b	P.Prodhues	41.9	Per pr.l.drusore	"	"	
59	211	"	Shkembj gjurajve	66c	Inproduktive	4.8	-	"	"	
60	212	"	Faqja e prozhmit	67b	P.Prodhues	44.9	Per pr.l.drusore	"	"	
61	213	"	Faqja e prozhmit	67c	Inproduktive	1.3	-	"	"	
62	214	"	Faqja e Hasit	68b	P.Prodhues	32.4	Per pr.l.drusore	"	"	
63	215	"	Rrasat e Plakmires	69b	P.Prodhues	8.5	Per pr.l.drusore	"	"	
64	216	"	Faqja e cetave	70a	P.Prodhues	43.7	per pr.l.drusore	"	"	
65	217	"	Faqja e cetave	70b	Inproduktive	3.0	-	"	"	
66	218	"	Faqja e arrzit	71a	P.Prodhues	32.9	Per pr.l.drusore	"	"	
67	219	"	Faqja e arrzit	71b	Inproduktive	11.1	-	"	"	
68	220	"	Faqja e rratheve	72a	P.Prodhues	7.0	Per pr.l.drusore	"	"	
69	221	"	Faqja e rratheve	72b	P.Prodhues	43.2	Per pr.l.drusore	"	"	
70	222	"	Faqja e rratheve	72c	Inproduktive	11.4	-	"	"	
71	223	"	Faqja e rrases	73a	P.Prodhues	8.0	Per pr.l.drusore	"	"	
72	224	"	Faqja e rrases	73b	P.Prodhues	14.9	Per pr.l.drusore	"	"	
73	225	"	Faqja e rrases	73c	Inproduktive	2.3	-	"	"	
74	226	"	Nen shpihn e Tahirrit	74a	P.Prodhues	20.1	Per pr.l.drusore	"	"	
75	227	"	Faqja e rrases	74b	P.Prodhues	11.9	Per pr.l.drusore	"	"	
76	228	"	Lugu rrases	75a	P.Prodhues	37.9	Per pr.l.drusore	"	"	
77	229	"	Lugu rrases	75c	Inproduktive	2.3	-	"	"	
78	230	"	Hija e Vashit	76a	P.Prodhues	37.0	Per pr.l.drusore	"	"	
79	231	"	Faqet e Hamalles	77a	P.Prodhues	46.2	Per pr.l.drusore	"	"	

80	232	"	Faqja e Ahujve	78a	P.Prodhues	18.4	Per pr.l.drusore	"	"	
81	233	"	Faqja e Ahujve	78b	Inproduktive	6.5	-	"	"	
82	234	"	Faqja e Ahujve	79a	P.Prodhues	31.1	Per pr.l.drusore	"	"	
83	235	"	Faqja e shpelles	80	P.Prodhues	46.9	Per pr.l.drusore	"	"	
84	253	"	Faqja e koderbardh.	89	P.Prodhues	44.6	Per pr.l.drusore	"	"	
85	254	"	Faqja e kr.Gjokes	90	P.Prodhues	43.1	Per pr.l.drusore	"	"	
86	255	"	Faqja e gurit Bal	91a	P.Prodhues	41.4	Per pr.l.drusore	"	"	
87	256	"	Shkambi i Qirasit	92a	P.Prodhues	32.9	Per pr.l.drusore	"	"	
88	257	"	Fq.Geshtenjave	93a	P.Prodhues	15.8	Per pr.l.drusore	"	"	
89	258	"	Fq.Prroit Fikut	94a	P.Prodhues	17.0	Per pr.l.drusore	"	"	
90	259	"	Fq.Prroit Fikut	95	P.Prodhues	38.2	Per pr.l.drusore	"	"	
91	260	"	Faqet e Fikut	96	P.Prodhues	34.3	Per pr.l.drusore	"	"	
92	273	"	Faqja e gallanes	105a	P.Prodhues	25.8	Per pr.l.drusore	"	"	
93	274	"	Faqja e thoreve	106a	P.Prodhues	25.0	Per pr.l.drusore	"	"	
94	275	"	Faqja e shkallores	107a	P.Prodhues	31.8	Per pr.l.drusore	"	"	
95	276	"	Mrapshtia e demave	108	P.Prodhues	31.0	Per pr.l.drusore	"	"	
96	277	"	Faqja e mesit	109a	P.Prodhues	49.3	Per pr.l.drusore	"	"	
97	278	"	Faqja e cetave mes	110	P.Prodhues	45.8	Per pr.l.drusore	"	"	
98	281	"	Fq.Prroit mesit	112a	P.Prodhues	25.8	Per pr.l.drusore	"	"	
99	282	"	Fq.Gurit	113	P.Prodhues	40.3	Per pr.l.drusore	"	"	
100	283	"	Faqja e Bunges	114a	P.Prodhues	33.0	Per pr.l.drusore	"	"	
101	292	"	Mbi fushen e Thanës	120	P.Prodhues	27.3	Per pr.l.drusore	"	"	
102	293	"	Rrahi vreshtave	121a	P.Prodhues	20.3	Per pr.l.drusore	"	"	
103	294	"	Faqja e lopeve	122a	P.Prodhues	51.8	Per pr.l.drusore	"	"	
104	295	"	Faqja e lopeve	122c	Inproduktive	2.8	-	"	"	
105	296	"	Faqja e Bunges	123a	P.Prodhues	26.0	Per pr.l.drusore	"	"	
106	300	"	Faqet e shehut	125	Inproduktive	24.8	-	"	"	
107	301	"	Faqja e keqit	126a	Inproduktive	28.3	-	"	"	
108	302	"	Faqja e cuttrit kuq	127a	P.Prodhues	21.8	Per pr.l.drusore	"	"	
109	303	"	Faqja e Goglekes	128	P.Prodhues	42.0	Per pr.l.drusore	"	"	

110	304	"	Faqja e zhyles	129a	P.Prodhues	5.5	Per pr.l.drusore	"	"	
111	305	"	Faqja e zhyles	129b	P.Prodhues	12.4	Per pr.l.drusore	"	"	
112	306	"	Faqja e Prozhmit	130a	P.Prodhues	23.3	Per pr.l.drusore	"	"	
113	307	"	Faqja e Prozhmit	130b	P.Prodhues	14.8	Per pr.l.drusore	"	"	
114	308	"	Faqja e Prozhmit	130c	Inproduktive	1.8	-	"	"	
115	319	"	Pylla e sulmules	136a	P.Prodhues	25.1	Per pr.l.drusore	"	"	
116	320	"	Faqet e gurit rrethit	137a	P.Prodhues	40.9	Per pr.l.drusore	"	"	
117	330	"	Faqja e Frashnit	141a	P.Prodhues	49.9	Per pr.l.drusore	"	"	
118	331	"	Faqja e Frashnit	141b	Inproduktive	3.3	-	"	"	
119	332	"	Shullani i Drites	142b	P.Prodhues	45.4	Per pr.l.drusore	"	"	
120	333	"	Shullani i Drites	142c	Inproduktive	9.3	-	"	"	
121	362	"	Faqja e Lugut Molles	154	P.Prodhues	52.5	Per pr.l.drusore	"	"	
122	363	"	Lugu mbasdushkut	155	P.Prodhues	50.7	Per pr.l.drusore	"	"	
123	364	"	Faqja e ermajt	156a	P.Prodhues	35.2	Per pr.l.drusore	"	"	
124	365	"	Faqja e Lumit	157a	P.Prodhues	53.4	Per pr.l.drusore	"	"	
125	366	"	Mbi shpija	158a	P.Prodhues	20.2	Per pr.l.drusore	"	"	
126	367	"	Faqja e rozave	159a	P.Prodhues	18.4	Per pr.l.drusore	"	"	
127	368	"	Shkembi Rozave	159b	Inproduktive	3.0	-	"	"	
128	369	"	Faqja e Pushtrikut	160a	P.Prodhues	10.1	Per pr.l.drusore	"	"	
129	370	"	Faqja e Pushtrikut	160b	Inproduktive	4.5	-	"	"	
130	371	"	Faqja e Molles	160c	P.Prodhues	11.0	Per pr.l.drusore	"	"	
131	390	"	Faqja e rrethit	173a	P.Prodhues	39.1	Per pr.l.drusore	"	"	
132	391	"	Faqja e rrethit	174a	P.Prodhues	35.1	Per pr.l.drusore	"	"	
133	392	"	Ballhana	175a	P.Prodhues	19.3	Per pr.l.drusore	"	"	
134	393	"	Ballhana	175b	P.Prodhues	19.3	Per pr.l.drusore	"	"	
135	394	"	Faqja e zhyles	176a	P.Prodhues	40.5	Per pr.l.drusore	"	"	
136	395	"	Faqja e zhyles	176b	P.Prodhues	4.0	Per pr.l.drusore	"	"	
137	396	"	Faqja e Bregut	177b	P.Prodhues	32.0	Per pr.l.drusore	"	"	
138	397	"	Faqja e Bregut	178b	P.Prodhues	11.0	Per pr.l.drusore	"	"	
139	398	"	Faqja e Brahimit	178c	P.Prodhues	7.0	Per pr.l.drusore	"	"	

140	399	"	Faqja e Brahimit	178d	Inproduktive	3.0	-	"	"	
141	419	"	Lami i gjyqeve	188b	P.Prodhues	10.8	Per pr.lende	"	"	
142	420	"	Lami i gjygjeve	188c	P.Prodhues	12.3	Per pr.lende	"	"	
143	421	"	Kodra e mullinit	189b	P.Prodhues	11.5	Per pr.lende	"	"	
144	422	"	Shkami i rrmolles	189c	P.Prodhues	37.5	Per pr.lende	"	"	
145	427	"	Faqja e menes	193b	P.Prodhues	37.8	Per pr.lende	"	"	
146	428	"	Faqja e frashnit	194b	P.Prodhues	31.5	Per pr.lende	"	"	
147	429	"	Shkambi Kumbulles	195a	P.Prodhues	39.5	Per pr.lende	"	"	
148	430	"	Faqja e Kumbulles	195b	P.Prodhues	5.5	Per pr.lende	"	"	
149	437	"	Bokat e Brdha	201	P.Prodhues	45.3	Per pr.lende	"	"	
150	438	"	Faqja e frashnit	202b	P.Prodhues	15.0	Per pr.lende	"	"	
151	439	"	Faqja e frashnit	202c	P.Prodhues	19.8	Per pr.lende	"	"	
152	440	"	Fusha e valeve	203b	P.Prodhues	18.8	Per pr.lende	"	"	
153	441	"	Faqja e seres Madhe	205b	P.Prodhues	31.3	Per pr.lende	"	"	
154	442	"	Faqja e gurit zi	206a	P.Prodhues	19.7	Per pr.lende	"	"	
155	443	"	Faqja e gurit zi	206b	P.Prodhues	10.8	Per pr.lende	"	"	
156	444	"	Faqja e gjelacit	207a	P.Prodhues	21.7	Per pr.lende	"	"	
157	445	"	Faqja e krojeve	207b	P.Prodhues	21.7	Per pr.lende	"	"	
158	448	"Prruemos-Sheldi"	Pikzat	1b	P.Prodhues	5.0	Per pr.lende	"	"	
159	449	"	Faqja e Qafkryqes	3	P.Prodhues	45.5	Per pr.lende	"	"	
160	450	"	Mreti That	4	P.Prodhues	55.0	Per pr.lende	"	"	
161	451	"	Semna	6	Kullote	26.0	Per nev.komun	"	"	
162	452	"	Semna	7	Kullote	30.0	Per nev.komun	"	"	
163	453	"	Semna	8	Kullote	49.5	Per nev.komun	"	"	
164	454	"	Semna	9	Kullote	65.2	Per nev.komun	"	"	
165	455	"	Semna	10	Kullote	37.4	Per nev.komun	"	"	
166	456	"	Semna	11	Kullote	32.4	Per nev.komun	"	"	
167	457	"	Semna	12	Kullote	45.3	Per nev.komun	"	"	
168	458	"	Semna	13	Kullote	36.9	Per nev.komun	"	"	
169	459	"	Semna	14	Kullote	40.5	Per nev.komun	"	"	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
119-134	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
140-167	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
187-235	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
253-260	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
273-278	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
281-283	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
292-296	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
300-308	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
319-320	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
330-333	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
362-371	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
39-399	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
419-422	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
427-430	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
437-445	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
448-450	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi
451-459	Pyll e sipërfaqe të tjera	Në pronësi

VENDIM**Nr.365, datë 27.3.2008**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër të qarkut të Beratit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 91 (nëntëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 627 (gjashtëqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Qendër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-214	Toka bujqësore produktive	Në përdorim
492-503 (vetëm kanale të treta)	Toka joproduktive dhe kanale të treta kulluese	Në pronësi
508-538, 540-542	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
543-562	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
563-565	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
566- 586	Varrezat publike	Në pronësi
587-597	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
604	Sistemi i largimit të ujërave të zeza	Në pronësi

VENDIM
Nr.366, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË SHKODËR TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.503, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Shkodër të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRI RENDOR I PRONËS NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1,7,13-23	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN ADMINISTRATIVE	NË PRONËSI
32-73	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE NË FUSHËN E ARSIMIT	NË PRONËSI
78-86,89-96	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E SHËNDETËSISË (SHËRBIMI PARËSOR)	NË PRONËSI
216,218-225 (PJESA E PAPRIVATIZUAR E 225);228- 234,241-243,579	PRONA QË PËRDOREN NË REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPORTIVE DHE KULTURORE	NË PRONËSI
107-110,121-135,173-205,840- 845	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK	NË PRONËSI
283-403	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE	NË PRONËSI
235, 241-248	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E SHËRBIMIT SOCIAL	NË PRONËSI
621-631	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E NDRICIMIT PUBLIK	NË PRONËSI
404-535,536-566/4,567-571,572- 577,581,582,580,619-620	INFRASTRUKTURË VENDORE (RRUGË, LULISHTË, TROTUAR SHESHE)	NË PRONËSI
578	SHËRBIM FUNERAL	NË PRONËSI

VENDIM
Nr.367, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS
ZHARRËZ TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zharrëz të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.562, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zharrëz të qarkut të Fierit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zharrëz për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Komuna: Zharrëz

Lidhja 1

NUMRI RENDOR I PRONËS NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
1-7	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE	NË PRONËSI
14-18	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E FUNKSIONEVE NË SHËNDETIN PUBLIK	NË PRONËSI
8-13	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE	NË PRONËSI
19-23	VARREZA PUBLIKE	NË PRONËSI
53-62	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE OSE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI	NË PËRDORIM
89-98	INFRASTRUKTURË (RRUGË VENDORE)	NË PRONËSI
63	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E SHËRBIMIT SOCIAL	NË PRONËSI
100,101	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E FURNIZIMIT ME UJË	NË PRONËSI
24-52	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E MBROJTJES CIVILE	NË PRONËSI
75,78,81,83,85	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM
76,77,79,80,82,84,86,87,88,124,127,132,135,140,141,158,160,163,177	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (KANALE TË TRETA DHE TOKA JOPRODUKTIVE)	NË PRONËSI

VENDIM
Nr.368, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “KORSEL” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “ÇARSHOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoriteti Kontraktues, dhe shoqërisë “Korsel” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Çarshovë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr.156 Rep
Nr.34 Kol

KONTRATË KONCESIONI
E FORMËS “BOT” (NDËRTIM-OPERIM-TRANSFERIM)
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “ÇARSHOVË”

Në Tiranë, më datë 23, muaji janar, viti 2008 (dy mijë e tetë), u paraqitën para meje notere Fatime B.Meta, regjistruar në Dhomën e Noterisë Tiranë, në adresën: rruga e Durrësit, pall.118, shk.1, ap.1, Palët Kontraktuese, si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktuar si “Autoritet Kontraktues”, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.130, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të hidrocentralit “Çarshovë”, që më poshtë do të quhet i tillë, përfaqësuar me autorizimin nr.1811/4, datë 2.8.2007, nga z.Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datëlindjes 11.6.1957, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi NF nr.489018

dhe

Shoqërisë “Korsel” sh.p.k., regjistruar si person juridik me vendimin nr.13999, datë 29.2.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”, përfaqësuar nga administratori z.Maksim Fejzullai, i biri i Hysenit, i datëlindjes 20.2.1955, banues në Korçë, rruga “Petraq Shomo”, nr.20, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta Z1913310, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

HYRJE

Duke pasur parasysh që qeveria e Shqipërisë:

1. i ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj ose rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistuese me anë të procedurave të koncesionit, për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar;

2. konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;

3. vlerëson formën “BOT të koncesionit, si një formë koncesioni që bën të mundur stimulimin e investitorëve privatë për ndërtimin e hidrocentraleve të rinj me anën e kapitalit privat;

4. është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;

5. mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

5.1 legjislacioni në fuqi rregullon dhënien me koncesion të hidrocentraleve dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.130, datë 14.3.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me

koncesion të hidrocentralit “Çarshovë”, autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për negociimin dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.

Koncesionari:

1. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit “Çarshovë”, komuna Çarshovë, rrethi Përmet, me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të zonës;

2. Shoqëria “Korsel” sh.p.k. zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiare, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektivit të kësaj marrëveshjeje;

3. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentralit “Çarshovë”, objekt i këtij koncesioni;

4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara, si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë marrëveshje përdoren termat e mëposhtëm, ata do të kenë kuptimet përkatëse si më poshtë vijon:

1.1 Marrëveshja e koncesionit: kjo marrëveshje dhe aneksi bashkëlidhur.

1.2 Autoriteti Kontraktues: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

1.3 Koncesionari: shoqëria “Korsel” sh.p.k., me seli në qytetin e Korçës.

1.4 Hidrocentral: tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike, ku përfshihen vepra e marrjes, kanali i devijimit, baseni i presionit, tubacioni që dërgon ujin në turbina, ndërtesa e centralit, së bashku me makineritë dhe pajisjet e instaluar në të që në rastin konkret është hidrocentrali “Çarshovë”, komuna Çarshovë, rrethi Përmet, me fuqi të instaluar 1200 kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 6 300 000 kWh, së bashku me të gjitha objektet që përmenden më sipër.

1.5 Kontratat: të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me sipërmarrësit për realizimin e punimeve.

1.6 Licencë: është akti administrativ, që lëshohet nga autoriteti përkatës publik për të ushtruar një veprimtari, bazuar në kriteret objektive të kualifikimit.

1.7 Tarifa koncesionare: sasia e energjisë elektrike që i ofrohet pa pagesë shtetit.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Objekti i kësaj kontrate koncesioni është:

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Neni 3

Periudha e koncesionit

Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit me koncesion ndërtimin e hidrocentralit “Çarshovë” për një periudhë 35-vjeçare sipas shkronjës “b” të nenit 27 të ligjit nr.9663, datë 18.6.2006 “Për koncesionet”. Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

4.1 të asistojë pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme, për marrjen e licencave dhe të lejeve të nevojshme për koncesion;

4.2 të miratojë projektin e zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari. Koha e nevojshme për miratimin e projektit nuk bën pjesë në grafikun e punimeve të parashikuara në aneksin 1, bashkëlidhur;

4.3 të kontrollojë rregullisht ecurinë e kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në të;

4.4 të garantojë blerjen e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a., për 15 vitet e para të prodhimit të energjisë elektrike.

Neni 5

Detyrimet dhe të drejtat e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari duhet që:

5.1 brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit, Koncesionari të formojë shoqërinë koncesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe transferimin e hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Shoqëria do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, si dhe në rast transferimi të aksioneve apo pjesëve të kapitalit të saj te të tretët, duhet të marrë pëlqimin e Autoritetit Kontraktues;

5.2 të fillojë punë brenda 30 ditëve nga data e miratimit të projektit të zbatimit;

5.3 të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas aneksit bashkëlidhur kontratës;

5.4 të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë koncesionare;

5.5 të marrë masa me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë kontratë dhe me cilësinë e kërkuar;

5.6 të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;

5.7 të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'u shkaktohen palëve të treta;

5.8 të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;

5.9 në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

Të marrë masa për të garantuar kushtet teknike për punëtorët dhe të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private, të respektojë legjislacionin në fuqi për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

5.10 Koncesionari detyrohet të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe ato noteriale;

5.11 të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues projektin e zbatimit sipas grafikut të punimeve, aneksi 1, bashkëlidhur;

5.12 të zbatojë projektin për ndërtimin e HEC-it "Çarshovë" me fuqi të vendosur prej 1200 kW.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 83 500 000 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind mijë) lekësh, nga të cilat 24 999 600 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) lekë do të investohen në makineri e pajisje.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve:

- pas variantit përfundimtar të projektzbatimit;

- në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e veprës, sipas efektivitetit të ofertave.

Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 83 500 000 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind mijë) lekë, por jo më e vogël se 79 325 000 (shtatëdhjetë e nëntë milionë e treqind e njëzet e pesë mijë) lekë, që përfaqëson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total të parashikuar.

Neni 7

Programi i punimeve

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm të punimeve:

7.1 Koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit bashkëlidhur.

7.2 Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt procedurale për marrjen e tyre.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës së koncesionit

8.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta prishë e kontratën e koncesionit në mënyrë të njëanshme:
a) kur Koncesionari nuk fillon punën për 6 muaj nga data e miratimit të projektit të zbatimit;
b) në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10% të asaj sipas projektit të propozuar nga Koncesionari;

c) kur Koncesionari kryen transferimin ose shitjen e kuotave pa miratim të Autoritetit Kontraktues.
8.2 Kur nga ana e Autoritetit Kontraktues provohet se gjatë periudhës së koncesionit ka shkelje të ndonjë prej pikave të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Koncesionarit duke pritur për një periudhë 30-ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse. Në rast mbarimi të këtij afati dhe Koncesionari nuk sjell përgjigje, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhë kontratën.

8.3 Në rastet kur Autoriteti Kontraktues zgjidh kontratën në mënyrë të njëanshme (pika 1 e këtij neni), ai ka të drejtë të marrë vlerën e garancisë së kontratës. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të marrë përsipër, përkohësisht, administrimin e HEC-it në sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë dhe, në rastin e dështimit nga Koncesionari, të përbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe të dështimit të tij, për të rregulluar shkeljen e kontratës.

8.4 Secila palë ka të drejtë të zgjidhë kontratën kur:
a) përbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë;

b) ka shkelje serioze nga pala tjetër e kur kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe sipas mënyrës së parashikuar në kontratën e koncesionit.

8.5 Palët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën e koncesionit me pëlqim të dyanshëm.

Neni 9 Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes ose nënkontraktorët, Koncesionari është i detyruar t'i respektojë kushtet e kësaj kontrate.

Pavarësisht nga kontratat e mësipërme, përgjegjësi para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen Autoritetit Kontraktues në këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve.

Koncesionari nuk ka të drejtë ta japë kontratën e koncesionit me nënkoncesion.

Neni 10 Garancitë

Koncesionari duhet të garantojë, për llogari të Autoritetit Kontraktues (sipas formularit të paraqitur në dokumentet e tenderit) para firmosjes së kontratës, një shumë të barabartë me 8 350 000 (tetë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekë të vlerës totale të investimit prej 83 500 000 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind mijë) lekësh.

Koncesionarit i lejohet ta çngurtësojë këtë vlerë vetëm pasi ta ketë marrë konfirmimin nga Autoriteti Kontraktues, brenda 30 ditëve nga realizimi i investimit dhe kryerja e testimit të veprës.

Neni 11 Sigurimet

Koncesionari do të sigurojë objektin gjatë gjithë periudhës së koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit.

Në rast se objekti i siguruar shkatërrohet ose dëmtohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilave është siguruar, zhvendëtimet në para të marra nga Koncesionari do të përdoren për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendje funksionale të paradëmtimit apo më mirë.

Kontraktori duhet të sigurohet për përgjegjësinë për dëme materiale dhe dëmtime trupore që mund t'u shkaktohen palëve të treta si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit/montimit, si dhe gjatë funksionimit të tij.

Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200 000 euro për çdo ngjarje dhe 500 000 euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 euro për çdo ngjarje dhe 2000 euro në vit.

Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 12

Kontrolli, raportimi, inspektimet dhe mbikëqyrja e përgjithshme

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kontrollojë Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

Koncesionari është i detyruar që çdo muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas prodhimin e energjisë elektrike.

Autoriteti Kontraktues ruan të drejtën që gjatë periudhës së koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të kontrollojë objektin për të vërtetuar nëse rregullat e koncesionit po kryhen sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë një mbikëqyrje të përgjithshme gjatë realizimit dhe vënies në punë, me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, ashtu si cilësia dhe konformiteti, të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të kontratës, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Neni 13

Tarifa koncesionare dhe vlera e riinvestimit

a) Tarifa koncesionare

Tarifa koncesionare është 2.5% e energjisë së prodhuar. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta shesë këtë sasi energjie për llogari të tij.

b) Vlera e riinvestimit

Vlera e riinvestimit është 50% e vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të investohet çdo 15 vjet dhe do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 14

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 15

Forca madhore

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj kontrate, duke bërë të pamundur përmbytjen e detyrimeve reciproke të marrëveshjes, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të palëve, për shkak të ngjarjeve të forcës madhore, ato nuk mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj kontrate do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, brenda 15 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve do të përcaktohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 16

Hyrja në fuqi e kontratës së koncesionit

Kontrata e koncesionit do të hyjë në fuqi pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 17

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemët ose mosmarrëveshjet midis palëve që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj kontrate koncesioni, nuk do të anulohen detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje duke u bazuar në vullnetin e mirë.

Në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 18

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj kontrate, në përfundim të periudhës 15-mujore penalizon Koncesionarin si më poshtë:

18.1 për shkelje të afatit të ndërtimit, 0,05% në ditë të vlerës të investimeve të munguara;

18.2 për moskryerje të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurrim, Koncesionari penalizohet me 10% të vlerës së investimeve të përealizuara;

18.3 për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve, penalizohet me 10 000 lekë;

18.4 në rast mosrealizimi, për faj të Koncesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 6.3 milionësh kWh në vit, Koncesionari penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të përealizuar për periudhën raportuese;

18.5 për mosrealizim deri në 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, ai do të penalizohet me 5% të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar;

18.6 nëse mosrealizimi i fuqisë së vendosur është më shumë se 10% të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar nga Koncesionari, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë ta prishë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Neni 19

Bashkëpunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhtme.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkohet Autoritetit Kontraktues nga Koncesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj kontrate.

Neni 20

Transferimi i aseteve

Me mbarimin e marrëveshjes koncesionare, qoftë si përfundim i afatit të zakonshëm, ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e koncesioneve, përfshirë çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Koncesionari në kantierin e koncesionit, do t'i transferohen Autoritetit Kontraktues, pa shpërblim apo detyrim shtesë, subjekt i termave dhe kushteve të marrëveshjes koncesionare. Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, por jo detyrimin, të ndërhyjë në çdo kontratë të Koncesionarit.

Neni 21

Regjistrimi i kësaj kontrate

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kontrata duhet të regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

AUTORITETI KONTRAKTUES:

**MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS**

KONCESIONARI:

SHOQËRIA “KORSEL” SH.P.K.

VENDIM
Nr.369, datë 27.3.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE ELEKTRIKE, TË PROJEKTUARA PËR
PËRDORIM BRENDË DISA KUFIJVE TË TENSIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
**PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE
ELEKTRIKE TË PROJEKTUARA PËR PËRDORIM BRENDË DISA KUFIJVE TË TENSIONIT**

1. Ky rregull teknik paracakton kërkesat thelbësore të sigurisë për pajisjet elektrike, si edhe paracakton procedurat e vlerësimit të konformitetit të tij.

2. Për qëllimet e këtij rregulli teknik, pajisje elektrike (më poshtë pajisje) është çdo pajisje për përdorim me një tension brenda kufirit 500-1000 V për rrymë alternative dhe me tension brenda kufirit 75-1500 V për rrymë të vazhduar.

3. Ky rregull teknik nuk zbatohet për pajisjet e mëposhtme:

- a) pajisje për përdorim në një atmosferë eksplozive;
- b) pajisje për qëllime të radiologjisë dhe mjekësore;
- c) pjesë elektrike të ashensorëve për mallra dhe pasagjerë;
- d) matësit elektrikë;
- e) priza dhe spina për përdorim shtëpiak;
- f) kontrolluesit e rrjeteve mbrojtëse elektrike;
- g) ndërhyrje radio-elektrike;
- h) pajisje të specializuara për përdorim në anije, në aviacion apo në hekurudhë, të cilat përshtaten me dispozitat e sigurisë të hartuara nga organizmat ndërkombëtarë në të cilët Shqipëria merr pjesë.

4. Pajisja vendoset në treg vetëm në qoftë se është ndërtuar në përputhje me praktikën e mirë inxhinierike në problemet e sigurisë, që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe kur ato nuk rrezikojnë sigurinë e personave, kafshëve shtëpiake dhe pronës, si dhe kur instalohen e mirëmbahen, ashtu si duhet dhe kur përdoren sipas destinacionit për të cilën është prodhuar.

5. Kërkesat thelbësore të sigurisë për pajisjet e projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit, referuar pikës 4, janë:

a) Kushtet e përgjithshme:

i) kërkesat thelbësore, njohja dhe mbajtja parasysh e tyre, siguron që pajisja të përdoret brenda kushteve të sigurisë dhe në përshtatje me destinacionin për të cilën është prodhuar, i vendoset marka e konformitetit, ose në qoftë se nuk është e mundur, i jepet një fletë shoqërimi;

ii) marka CE vendoset në pajisje në mënyrë të dukshme, lehtësisht të lexueshme, dhe kur nuk është e mundur, vendoset në ambalazh;

iii) pajisja, së bashku me pjesët e saj përbërëse, prodhohet (formohet) në mënyrë të tillë që të garantojnë montim dhe lidhje të rregullt dhe të sigurt;

iv) pajisja projektohet dhe prodhohet në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen nga rreziqet siç përcaktohet në pikat 6/b dhe 6/c të këtij rregulli teknik, me kusht që pajisja të përdoret në destinacionin e saj dhe të mirëmbahet.

- b) Mbrojtja kundër rreziqeve që vijnë nga pajisjet:
Masa me natyrë teknike të përshkruara në pajtim me pikën 6/a, me qëllim që të garantojnë:
i) personat dhe kafshët shtëpiake të jenë të mbrojtur ashtu siç duhet nga rreziku i dëmtimeve fizike apo dëmtimeve të tjera që mund të shkatohen nga kontakti direkt ose indirekt elektrik;
ii) të mos prodhohen temperatura, harqe elektrike ose rrezatime, që shkatojnë rrezik;
iii) personat, kafshët shtëpiake dhe pronat të jenë më së miri të mbrojtura nga rreziqet jo të natyrës elektrike të shkaktuara nga pajisjet, të cilat konstatohen nga përvoja;
iv) izolimi të jetë i përshtatshëm për kushtet që parashikohen.
- c) Mbrojtja kundër rreziqeve që mund të shkatohen nga ndikimi i jashtëm mbi pajisjet. Masat teknike duhet të parashikohen në lidhje me pikën 6/a, me qëllim që të sigurojnë:
i) që pajisjet të përputhen me kërkesat e pranuar mekanike, në mënyrë të tillë që personat, kafshët shtëpiake, pronat të mos rrezikohen;
ii) që pajisjet t'i rezistojnë të gjitha ndikimeve jomekanike në kushte të njohura të mjedisit, në mënyrë të tillë që personat, kafshët e pasuria të mos rrezikohen;
iii) që pajisjet të mos rrezikojnë personat, kafshët shtëpiake dhe pasurinë në kushte të parashikueshme të mbingarkesës.

6. Nuk janë detyruese kërkesat thelbësore të sigurisë, më strikte se ato të parashikuara në pikat 4 dhe 5, për operatorët furnizues me elektricitet, për lidhjet në rrjet apo për furnizimin me energji të përdoruesve të pajisjeve.

7. Kontrolli i brendshëm i prodhimit është procedura me anën e së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, siguron dhe deklaron që pajisjet i përmbushin kërkesat thelbësore në zbatim të këtij rregulli teknik që zbatohet për to.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, vendos markën CE në çdo produkt dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit sipas pikës 13.

a) Fabrikuesi përgatit dokumentacionin teknik të përshkruar në pikën 8 dhe ai ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij e mban atë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, për qëllime kontrolli, për një periudhë 10-vjeçare pas prodhimit të produktit të fundit.

Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i autorizuar prej tij nuk janë vendosur në Republikën e Shqipërisë, ky detyrim është përgjegjësi e personit që vendos pajisjet në treg.

b) Dokumentacioni teknik krijon mundësinë që të vlerësohet konformiteti i pajisjes me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik. Për sa kohë është e nevojshme për këtë vlerësim, ky dokumentacion përmban projektimin, prodhimin dhe funksionimin e pajisjes.

Ai përfshin:

- i) një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes;
 - ii) projektimin konceptual, projektet e prodhimit dhe skemat e komponentëve, nënmontimeve, qarqeve etj.;
 - iii) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme për të kuptuar projektet e skemat e lartpërmendura, si dhe funksionimin e pajisjeve;
 - iv) listën e standardeve të harmonizuara shqiptare të zbatuara plotësisht apo pjesërisht dhe, kur këto standarde nuk janë zbatuar, përshkrimet e zgjidhjeve teknike të zbatuara për përmbushjen e aspekteve të sigurisë së këtij rregulli teknik;
 - v) rezultatet e përllogaritjeve të bëra për projektimet, ekzaminimet e kryera etj.;
 - vi) raportet e provave.
- c) Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar prej tij mban një kopje të deklaratës së konformitetit me dokumentacionin teknik.

d) Fabrikuesi merr të gjitha masat e domosdoshme, me qëllim që procesi i prodhimit të sigurojë konformitetin e produkteve të prodhuara me dokumentacionin teknik dhe me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik që zbatohen për to.

8. Deklarata EC e konformitetit përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e fabrikuesit, ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij, i vendosur në Republikën e Shqipërisë;
- b) një përshkrim të pajisjeve;
- c) referencën në standardet e harmonizuara shqiptare;
- d) kur është e përshtatshme, referencat në specifikimet teknike me të cilat deklarohet konformiteti;
- e) identifikimin e nënshkruesit, të cilit i është dhënë e drejta të hyjë në marrëveshje në emër të fabrikuesit ose përfaqësuesit të autorizuar prej tij;
- f) dy shifrat e fundit të vitit kur është vendosur marka EC.


9. Përpara vendosjes në treg, pajisjes i vendoset marka CE, parashikuar në pikën 14, që dëshmon konformitetin e saj me dispozitat e këtij rregulli teknik, përfshirë procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në pikën 7.

10. Në rast të një sfide apo mosmarrëveshjeje, fabrikuesi apo importuesi paraqet një raport të hartuar nga një organ i autorizuar në lidhje me përputhshmërinë e pajisjes me dispozitat e pikës 4 dhe 5.

11. Kur pajisja është subjekt dhe i rregullave teknike të tjera lidhur me aspekte të tjera, të cilat gjithashtu parashikojnë vendosjen e markës CE, kjo e fundit tregon që pajisja në fjalë prezumohet se është në përputhje edhe me dispozitat e këtyre rregullave të tjera teknike.

12. Megjithatë, kur një ose më shumë prej këtyre rregullave teknike lejojnë fabrikuesin, që gjatë një periudhe kalimtare të zgjedhë cilat kërkesa të zbatohet, marka CE tregon konformitetin vetëm me dispozitat e atyre rregullave teknike të zbatuara nga fabrikuesi. Në këtë rast veçantitë e rregullave teknike të zbatuara jepen në dokumentet, njoftimet ose udhëzimet e kërkuara nga rregullat teknike dhe që shoqërojnë pajisjet.

13. Marka CE e konformitetit përbëhet nga inicialet CE në formën e mëposhtme:



a) Në rast se marka CE zvogëlohet ose zmadhohet, përmasat e vizatimit të shkallëzuar më lart duhet të respektohen.

b) Përbërësit e ndryshueshëm të markimit CE duhet të kenë ekzaktësisht të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk mund të jetë më pak se 5 mm.

14. Fabrikuesit ose përfaqësuesit i autorizuar prej tij vendos markën e konformitetit CE, referuar pikës 13, pajisjes ose, në pamundësi të kësaj, ambalazhit, broshurës së udhëzimeve ose certifikatës së garancisë, në mënyrë të tillë që ajo të jetë e dukshme, lehtësisht e lexueshme dhe pa mundësi fshirjeje.

15. Ndalohet vendosja në pajisje e çdo marke tjetër që mund të mashtrrojë palët e treta lidhur me kuptimin dhe formën e markës CE. Megjithatë, çdo markë tjetër mund të vendoset në pajisje, ambalazhin e saj, broshurës së udhëzimeve ose certifikatës së garancisë, me kusht që kjo të mos cenojë pamjen dhe leximin e markës CE.

16. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton që marka CE është vendosur me pa të drejtë, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, është i detyruar të sjellë pajisjen në konformitet me dispozitat përkatëse për vendosjen e markës CE dhe t'i japë fund shkeljes sipas kushteve të vendosura nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

17. Kur moskonformiteti vazhdon, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e duhura që të kufizojë ose të ndalojë vendosjen në treg të pajisjes në fjalë, ose të sigurojë që ajo të tërhiqet nga tregu në përputhje me pikën 18.

18. Në qoftë se, për arsye sigurie, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ndalon vendosjen në treg të ndonjë pajisjeje, apo pengon lëvizjen e saj të lirë, duhet menjëherë të informojë ministrinë për këtë problem duke përcaktuar arsyet për këtë vendim dhe duke nënvizuar në veçanti:

a) nëse moskonformiteti me pikat 4 dhe 5 ka lidhje me mangësitë në standardet e harmonizuara shqiptare;

b) nëse moskonformiteti me pikat 4 dhe 5 ka lidhje me zbatimet e gabuara të këtyre standardeve, apo të publikimeve, apo të metave në zbatimin e praktikës së mirë inxhinierike.

VENDIM
Nr.370, datë 27.3.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
RRËSHEN-KALIMASH (PJESA E KATËRT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash (pjesa e katërt).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 71 775 m² tokë/arë, e vlerësuar me çmimin 650 lekë/m², me vlerë shpronësimi 46 653 750 (dyzet e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, për sipërfaqen 14 610 m² tokë truall, të vlerësuar me çmimin 1 500 lekë/m², me vlerë 21 915 000 (njëzet e një milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 68 568 750 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 3 490 000 (tre milionë e katërqind e nëntëdhjetë mijë), të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 68 568 750 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.4.2008 dhe të përfundojë më 1.7.2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmim i ZRPP-së”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin në përputhje me dokumentacionin e pronësisë, që do t’i vihet në dispozicion nga pronarët.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

AUTOSTRADA "RRËSHEN - KALIMASH"

LISTA E SHPRONËSIMEVE PËR SEKSIONIN "ZAJC - KLOS"

Nr	(EMRI,ATESIA,MBIEMRI)	NR.ZK	NR. PASU	SIP. ARE (m2)	CMIMI	VLERA LEKE	SIP. TRUALL (M2)	CMIMI	VLER A LEKE	VLERA TOTALE	SHENIME	FSHATI
1	NDUE FRROK MARKU	1893	425	762	650	495300				495300	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
2	NDUE FRROK MARKU	1893	422				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
3	DAVA GJON NIKOLLI	1893	428	146	650	94900				94900	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
4	GJERGJ FRROK MARKU	1893	423	87	650	56550				56550	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
5	GJERGJ FRROK MARKU	1893	420	425	650	276250				276250	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
6	GJERGJ FRROK MARKU	1893	419		650		300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
7	MARK ZEF SHYTI	1893	418	1242	650	807300				807300	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
8	MARK SHYTI	1893	413				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
9	MARK ZEF SHYTI	1893	416	792	650	514800				514800	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
10	NDUE DOD KAZA	1893	355	809	650	525850				525850	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
11	MARK ZEF SHYTI	1893	415	605	650	393250				393250	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
12	ANTON FRAN ZEFI	1893	412	537	650	349050				349050	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
13	ANTON FRAN ZEFI	1893	411	450	650	292500				292500	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
14	ANTON FRAN ZEFI	1893	364				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
15	ANTON FRAN ZEFI	1893	356	618	650	401700				401700	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
16	PJETER ZEF SHYTI	1893	357	578	650	375700				375700	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
17	GJERGJ ZEF SHYTI	1893	358	585	650	380250				380250	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC

18	MARK PRENG KAZA	1893	359	566	650	367900				367900	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
19	PJETER ZEF SHYTI	1893	360	956	650	621400				621400	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
20	GJERGJ ZEF SHYTI	1893	361	580	650	377000				377000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
21	PJETER ZEF KAZA	1893	341	443	650	287950				287950	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
22	LLESH GJOK KAZA	1893	342	250	650	162500				162500	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
23	PASHK GJOK KAZA	1893	339	389	650	252850				252850	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
24	NIKOLL GJOK KAZA	1893	338	944	650	613600				613600	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
25	PASHKE BARDHOK KAZA	1893	337	118	650	76700				76700	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
26	GJETMARK KAZA	1893	336	102	650	66300				66300	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
27	LLESH GJOK KAZA	1893	335/1	175	650	113750				113750	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
28	PJETER ZEF SHYTI	1893	365				272	1500	408000	408000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
29	GJERGJ ZEF SHYTI	1893	363				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
30	BARDHOK KAZA	1893	370	31	650	20150				20150	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
31	DEDIN PRENG KOKA	1893	333	115	650	74750				74750	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
32	BARDHOK PRENG KOKA	1893	332	4230	650	2749500				2749500	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
33	PETRIT PRENG KOKA	1893	258/1	807	650	524550				524550	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
34	DEDIN PRENG KOKA	1893	258/2	2233	650	1451450				1451450	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
35	BESMIR NIKOLL GJOKA	1893	263/1	220	650	143000	500	1500	750000	893000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
36	NIKOLL NDUE GJOKA	1893	263/2	1393	650	905450				905450	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
37	NIKOLL NDUE GJOKA	1893	268				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	ZAJC
38	MRIK MARK LLESHI (BASHKEPRONARE)	1893	32	1760	650	1144000				1144000	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI

39	PJETER NIKOLL LLESHI	1893	33	2382	650	1548300				1548300	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
40	MRICA MARK LLESHI	1893	29	956	650	621400				621400	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
41	MRICA MARK LLESHI (BASHKEPRONARE)	1893	31				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
42	PJETER NIKOLL LLESHI	1893	30	396	650	257400				257400	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
43	PJETER NIKOLL LLESHI	1893	34				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
44	MRIK MARK LLESHI (BASHKEPRONARE)	1893	36	2145	650	1394250				1394250	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
45	SIMON PJETER LLESHI	1893	37	778	650	505700				505700	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
46	SIMON PJETER LLESHI	1893	35				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
47	SIMON PJETER LLESHI	1893	43	831	650	540150				540150	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
48	PJETER NIKOLL LLESHI	1893	40	1532	650	995800				995800	KONFIRMIM ZRPP	SHMRI
49	DED LASKA	3433	2/1	1250	650	812500				812500	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
50	NDREC NDUE LASKA	3433	2/2	1750	650	1137500				1137500	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
51	NDREC NDUE LASKA	3433	3				500	1500	750000	750000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
52	GJIN NIKOLL NIKOLLI	3433	59/4	600	650	390000				390000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
53	NIKOLL DOD NIKOLLI	3433	59/5				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
54	GJIN NIKOLL NIKOLLI	3433	59/10				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
55	GJET DOD NIKOLLI	3433	59/3				200	1500	300000	300000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
56	DED DOD NIKOLLI	3433	59/9				200	1500	300000	300000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
57	VIKTOR DED NIKOLLI	3433	59/11	700	650	455000				455000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
58	PASHK DED NIKOLLI	3433	59/7	175	650	113750				113750	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
59	FRAN GJON PJETRI	3433	57	250	650	162500				162500	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J

60	FRAN GJON PJETRI	3433	58	150	650	97500				97500	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
61	VIKTOR FRAN PJETRI	3433	55/1				500	1500	750000	750000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
62	PRENG ZEF GJOKA	3433	81/11				250	1500	375000	375000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
63	BARDHOK PJETER PJETRI	3433	54/1	1000	650	650000	800	1500	120000 0	1850000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
64	MARTE PRENG VORFI	3433	49	300	650	195000				195000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
65	PASHK PRENG LLESHI	3433	50	800	650	520000				520000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
66	DAVA PRENG LLESHI (BASHKEPRONARE)	3433	51/1	1900	650	1235000				1235000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
67	PASHK PRENG LLESHI	3433	48	400	650	260000				260000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
68	DAVA NDUE LLESHI (BASHKEPRONARE)	3433	47/1	500	650	325000				325000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
69	GJON NDUE NDOI	3433	52	800	650	520000	800	1500	120000 0	1720000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
70	MARA NDUE PRENGA	3433	47/2	650	650	422500				422500	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
71	GJON NDUE NDOI	3433	45/2	2100	650	1365000				1365000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
72	NDUE ZEF ZEFI	3433	42/5	1000	650	650000				650000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
73	MARA NDUE PRENGA	3433	46	100	650	65000				65000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
74	MARK PRENG GJOKA	3433	43/2	200	650	130000				130000	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
75	ALEKSANDER ZEF MARKU	3433	42/1	2375	650	1543750				1543750	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
76	GJON NDUE NDOI	3433	44	525	650	341250				341250	KONFIRMIM ZRPP	SHTRUNGA J
77	NDUE MARK GJOKA	1190	56	200	650	130000	800	1500	120000 0	1330000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
78	NDUE ZEF PERSHQEFA	1190	47/1	850	650	552500				552500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
79	NDUE ZEF PERSHQEFA	1190	50	1039	650	675350				675350	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
80	NDUE ZEF PERSHQEFA	1190	49/2	27	650	17550				17550	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
81	NDUE MARK GJOKA	1190	54/1	250	650	162500				162500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK

82	PAL MARK LAZRI	1190	54/2	250	650	162500				162500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
83	NDUE MARK GJOKA	1190	51	450	650	292500				292500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
84	NDUE GJOK PERSHQEFA	1190	47/2	900	650	585000				585000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
85	MARK PRENG GEGA	1190	45	322	650	209300				209300	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
86	NDUE GJOK PERSHQEFA	1190	26/2	801	650	520650				520650	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
87	GJON ZEF GEGA	1190	20	200	650	130000				130000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
88	MARA ZEF MARLEKA	1190	16/1	1100	650	715000				715000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
89	GJOVALIN MARK NDOJA	1190	29/2	423	650	274950				274950	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
90	DAVA GJIN NDOI (BASHKEPRONARE)	1190	16/2	450	650	292500	150	1500	225000	517500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
91	BARDHOK SHYTI	1190	11/2	81	650	52650				52650	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
92	BARDHOK SHYTI	1190	11/3	1065	650	692250				692250	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
93	PJETER DOD SHYTI	1190	27/1				288	1500	432000	432000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
94	KOL ZEF PRENGA	1190	27/3				200	1500	300000	300000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
95	BARDHOK SHYTI	1190	10	300	650	195000				195000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
96	MEHILL ZEF PRENGA	1190	9/1	150	650	97500				97500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
97	MEHILL ZEF PRENGA	1190	9/2				250	1500	375000	375000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
98	ZEF NIKOLL NIKOLLI	1190	8	100	650	65000	800	1500	120000	1265000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
99	PJETER DOD PRENGA	1190	4/1	350	650	227500	750	1500	112500	1352500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
100	MEHILL ZEF PRENGA	1190	3/3	100	650	65000				65000	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
101	KIN ZEF PRENGA	1190	2	150	650	97500	200	1500	300000	397500	KONFIRMIM ZRPP	BISAK
102	NDUE MARK MENA	2162	86/1	400	650	260000				260000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS

103	NDUE MARK MENA	2162	85	500	650	325000				325000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
104	PRENG GJET PRENGA	2162	83	64	650	41600				41600	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
105	GJET PRENG MARKU	2162	81/1	213	650	138450				138450	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
106	GJET PRENG MARKU	2162	84/1				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
107	NIKOLL LLESH PRENGA	2162	84/2				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
108	PRENG MARK MENA	2162	84/3				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
109	GJIN ZEF TUCI	2162	84/9	270	650	175500				175500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
110	GJIN ZEF TUCI	2162	84/4				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
111	DAVA NIKOLL TUCI (BASHKEPRONARE)	2162	84/5				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
112	DAVA NIKOLL TUCI	2162	84/12	208	650	135200				135200	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
113	MARK NDUE NIKOLLI	2162	88/7	650	650	422500				422500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
114	MARK NDUE NIKOLLI	2162	88/1				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
115	NIKOLL NDUE NIKOLLI	2162	88/13				150	1500	225000	225000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
116	PASHK ZEF TUCI	2162	88/3				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
117	GJET MARK TUCI	2162	88/4				300	1500	450000	450000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
118	GJET MARK TUCI	2162	88/9	650	650	422500				422500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
119	MARK ZEF LLESHI	2162	88/10	408	650	265200	500	1500	750000	1015200	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
120	KOL NDUE LLESHI DAVA NDUE LLESHI	2162	88/11	176	650	114400				114400	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
121	GJOVALIN MARK PRENGA	2162	94	155	650	100750				100750	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
122	PJETER NDREC MEHILLI	2162	95/1	100	650	65000				65000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
123	KOL NDUE LLESHI	2162	98/4	750	650	487500				487500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
124	KOL NDUE LLESHI	2162	99/8	924	650	600600				600600	KONFIRMIM ZRPP	KLOS

125	NDUE GJET MARKU	2162	98/3	200	650	130000				130000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
126	NDUE GJET MARKU	2162	99/7	354	650	230100				230100	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
127	PRENG GJET MARKU	2162	99/6	923	650	599950				599950	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
128	PRENG GJET MARKU	2162	98/2	450	650	292500				292500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
129	PJETER PRENG MARKU	2162	98/1	40	650	26000				26000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
130	PJETER PRENG MARKU	2162	99/5	339	650	220350				220350	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
131	NDUE PJETER MARKU	2162	99/10	300	650	195000				195000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
132	FRROK PAL MARGJECI	2162	99/1	2250	650	1462500				1462500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
133	FRROK PAL MARGJECI	2162	100	300	650	195000				195000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
134	MARA GJON GJOKA (BASHKEPRONARE)	2162	69/1	400	650	260000	800	1500	120000 0	1460000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
135	MARK NDUE GJOKA	2162	69/2	600	650	390000				390000	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
136	MARA GJON GJOKA (BASHKEPRONARE)	2162	68/1	150	650	97500				97500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
137	MARK NDUE GJOKA	2162	68/2	350	650	227500				227500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
138	MARA GJON GJOKA (BASHKEPRONARE)	2162	67/1	250	650	162500				162500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
139	MARK NDUE GJOKA	2162	67/2	350	650	227500				227500	KONFIRMIM ZRPP	KLOS
	TOTALI			71775		46653750	14610		219150 00	68568750		

VENDIM
Nr.371, datë 27.3.2008

PËR KRITERET E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË TRAKTORËVE, MAKINERIVE E PAJISJEVE, TË MARRA NGA PËRDORUESIT, SI DHE TË MAKINERIVE, PAJISJEVE E PJESËVE TË KËMBIMIT, GJENDJE NË MAGAZINËN E PROJEKTIT “RRITJA E PRODHIMIT USHQIMOR, 2 KR”, TË ARDHURA GRANT NGA JAPONIA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Kriteret e vlerësimit

1. Vlerësimit i nënshtrohen vetëm traktorët, makineritë dhe pajisjet, që u janë marrë përdoruesve, të cilët nuk kanë likuiduar vlerën e tyre, sipas afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur, ndërmjet projektit 2 KR dhe përfituesve.

2. Për vlerësimin e traktorëve, të makinerive e të pajisjeve, të marra nga përdoruesit, të cilët nuk kanë likuiduar vlerën e tyre, me propozimin e drejtorit të projektit 2 KR, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, miraton komisionin e vlerësimit, i cili përcakton vlerën për çdo traktor, makineri dhe pajisje.

3. Komisioni i vlerësimit, për përcaktimin e vlerës, merr parasysh vlerën fillestare, orët e punës, që ka kryer mjeti, dhe gjendjen aktuale teknike të tij në çastin e vlerësimit.

II. Procedurat e shitjes

1. Objekt shitjeje janë:

a) traktorët, makineritë dhe pajisjet, të marra nga përdoruesit, të cilët nuk kanë likuiduar vlerën e tyre;

b) makineritë, pajisjet dhe pjesët e këmbimit, të papërdorura, gjendje në magazinat e projektit 2 KR, të ardhura grant nga qeveria japoneze, të cilat nuk janë shitur, pas zhvillimit të disa ankandeve.

2. Shitja e traktorëve, makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit bëhet nëpërmjet ankandit.

3. Vlera e fillimit të ankandit është:

a) për traktorët, makineritë dhe pajisjet e marra nga përdoruesit, ajo e përcaktuar nga komisioni i vlerësimit;

b) për makineritë, pajisjet dhe pjesët e këmbimit të pashitura, 75 për qind më e ulët se vlera fillestare, sipas kontabilitetit.

4. Pas përcaktimit të vlerës, sipas pikës 3 të këtij vendimi, fillon procedura e botimit të njoftimit për shpalljen e ankandit, dy herë radhazi në Buletinin e Njoftimeve Publike, periudhë e cila zgjat 14 ditë. Në njoftim përcaktohen dy data, me një afat kohor prej 5 ditësh, për zhvillimin e ankandit. Brenda këtij afati, njoftimi botohet edhe në dy gazeta, me qarkullim kombëtar.

5. Kur nga zhvillimi i ankandit mbeten traktorë, makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi të pashitura, projekti 2 KR i propozon Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit uljen e vlerës së publikuar për shitje, deri në 50 për qind. Në këto raste, zbatohen të gjitha procedurat e ankandit.

6. Kur edhe pas zhvillimit të procedurave të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, mbeten ende pa u shitur traktorë, makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi, për të cilat, gjatë një periudhe 2-mujore nga përfundimi i ankandit, janë paraqitur kërkesa për blerjen e tyre apo të pjesëve të veçanta, ato shiten pa ankand, nëpërmjet një komisioni shitjeje, të ngritur nga projekti 2 KR, me vlerën e përcaktuar në ankandin e fundit.

7. Gjatë kësaj periudhe 2-mujore njoftohen për gjendjen e mallrave edhe institucionet shtetërore, që kanë interes për përdorimin e tyre. Në bazë të kërkesave dhe të gjendjes fizike, kryhet transferimi i këtyre mallrave, me miratimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

8. Në përfundim të të gjitha këtyre procedurave dhe të afatit 2-mujor, projekti 2 KR i propozon Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit sistemimin e tyre në magazinat shtetërore ose nxjerrjen jashtë përdorimit.

9. Për traktorët, agregatet dhe pajisjet e blera nga institucionet shtetërore, të cilat nuk kanë shlyer detyrimet, sipas kontratave me projektin “Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR”, kryhet transferimi kapital i

tyre, me miratimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Diferencat financiare ndërmjet çmimit që është në kontabilitet dhe çmimit të shitjes së mallrave, si pasojë e transferimeve kapitale, t'i pakësohen fondeve kondërparti të projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR".

11. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të hartojë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi nr.148, datë 31.3.2000 i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e shitjes së mallrave, të ardhura grant nga Japonia, në kuadër të projektit "Rritja e prodhimit ushqimor, 2 KR"", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.372, datë 27.3.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.49, DATË 27.11.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIZIMIN, VARËSINË
STRUKTURE DHE LIMITIN ORGANIK TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2003 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet vendimit nr.49, datë 27.1.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

"Oficeri shoqëruar, në përbërjen organike të grupit të shoqërimit të Kryetarit të Kuvendit, nga "niveli i mesëm" bëhet "niveli i lartë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.373, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË
MEMALIAJ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.471, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve mësimore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin pulik	Në pronësi
11-13	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive	Në pronësi
14,15,16	Shërbimi funeral	Në pronësi
17,19,47,68-114,116-124,169,204-241	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
18,20-45,48-67,115,125	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
126,127-141	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile dhe strehimit	Në pronësi
147	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
175-179,181-183, 185-198	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore	Në përdorim
46,180,184	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë, tokë jobujqësore	Në pronësi
149-168	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
199,200	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza	Në pronësi

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “URA LIDHËSE, LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ura lidhëse, Lezhë”.”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 12 078 m² tokë arë, e vlerësuar me 427 lekë/m², për jonxhë dhe kultura drufrutore, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 305 000 (treqind e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave “Fondi i shpronësimeve”, pranë Bankës së Shqipërisë.

6. Shpronësimi dhe likuidimi i pronarëve të bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të përfundojnë deri më 1.6.2008.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë subjektit kërkues, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE, TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN, SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË RRUGËS LIDHËSE, LEZHË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.Kadas	Nr.pas	Sip/m ²	Çmimi tokë/arë	Vlera/lekë	Çmimi jonxhë lek/m ²	Vlera kultura bujq/lekë	Vlera dru frut/lekë	Totali/lekë	Shënime
1	Katerina	Pjetër	Lekaj	1986	52/3	534	427	228 018				228018	Plot.dok
2	Shtjefën	Fran	Lekaj	1986	52/7	2030	427	866 810	27	54 810	377 000	1298 620	Plot.dok
3	Pashk	Gjon	Lekaj	1986	52/9	850	427	362 950	27	22 950	122 000	507 900	Plot.dok
4	Zef	Pashk	Lekaj	1986	52/10	850	427	362 950			116 000	478 950	Plot.dok
5	Vasil	Prek	Lekaj	1986	52/13	675	427	288 225				288 225	Plot.dok
6	Luigj	Prek	Loshi	1986	52/14	675	427	288 225			162 000	450 225	Plot.dok
7	Ndue	Zef	Leka	1986	52/15	1202	427	513 254	27	32 454		545 708	Plot.dok
8	Luigj	Martin	Lekaj	1986	52/16	926	427	395 402	27	25 002		420 404	Plot.dok
9	Losh	Lek	Lekaj	1986	52/18	406	427	173 362	27	10 962		184 324	Plot.dok
10	Prendaqe	Kol	Lekaj	1986	52/19	375	427	160 125				160 125	Plot.dok
11	Ndue	Gjergj	Lekaj	1986	52/20	375	427	160 125			22 000	182 125	Plot.dok
12	Gjok	Pjetër	Lekaj	1986	49/5	860	427	367 220	27	23 220	191 500	581 940	Plot.dok
13	Luigj	Prek	Loshi	1986	49/1	220	427	93 940				93 940	Plot.dok
14	Ndue	Zef	Leka	1986	49/2	560	427	239 120	27	15 120	358 000	612 240	Plot.dok
15	Luigj	Martin	Lekaj	1986	49/3	840	427	358 680	27	22 680	305 000	686 360	Plot.dok
16	Losh	Lek	Lekaj	1986	49/4	700	427	298 900	27	18 900	200 000	517 800	Plot.dok
	Shuma					12078		5 157 306		226 098	1 853 500	7 236 904	

Vlera totale e shpronësimit është 7 236 904 (shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e katër) lekë.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 14.4.2008
 Doli nga shtypi më 16.4.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
 Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë